



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

*Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme,
Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit*

Nr. 990/7 Prot.

Tiranë, më 26/02/2017

V E N D I M

Nr.12, Datë 26.02.2017

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t, QARKU LEZHË “MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtorit Përgjithshëm në mbështetje të neneve 10, 15, 25,26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Lezhë, për periudhën nga data 01.01.2014 deri me datë 30.09.2016 .

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim” të ushtruar në Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Drejtoria Rajonale Lezhë.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë nuk janë zbatuar rekomandimet:

a- Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë të bashkëngjitë parcelave ndërtimore sipërfaqet e poseduara por të pa llogaritura për pagesë, në 30 raste me sipërfaqe totale 14157 m² llogaritur në vlerë 161,729,059 lekë, në rastet kur këto sipërfaqe, posedohen nga më shumë së një individë dhe është e pa mundur të konfigurohen parcela të veçanta ndërtimore, të bashkëpunohet me njësitë qeverisjes vendore dhe ZVRPP dhe të veprohet sipas kërkesave të nenit 17, pika 1, të ligjit nr 9482 datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, mars 2014.

b- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë edhe për periudhën në vazhdim, për çdo rast të ndërtimeve informale që shtrihet jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara, të llogarisë detyrimin për pagesë në sipërfaqet e poseduara të parcelave mbi 500 m², me çmimet e tregut në zbatim të nenit 17, pika 1, e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje”.

c- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë të rakordojë me 5 bashkitë dhe 16 komunitat e qarkut Lezhë, për pronat e paluajtshme (troje e ndërtesa) të kaluara në inventarë pronësie të njësive të qeverisjes vendore me vendime të Këshillit të Ministrave, për të shmangur përplasjet mes vendimeve të Këshillit të Ministrave, Janar 2014.

d- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë, për 663 raste aplikimesh të cilat i përkasin ndërtesave pa leje në zonën arkeologjike dhe zona bregdetare, për të cilat nuk është plotësuar aktkualifikimi dhe janë jashtë zonave, objekt veprimi të ligjit që duheshin skualifikuar në zbatim të VKM nr. 515 datë 13.05.2009, “Për përcaktimin afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, i ndryshuar pika 3.2.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë të marrë masa konkrete dhe të dokumentuara në çdo fazë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm si:

a- për tu bashkëngjitur parcelave ndërtimore sipërfaqet e poseduara por të pa llogaritura për pagesë, në 30 raste me sipërfaqe totale 14157 m² llogaritur në vlerë 161,729,059 lekë, në rastet kur këto sipërfaqe, posedohen nga më shumë së një individë dhe është e pa mundur të konfigurohen parcela të veçanta ndërtimore, të bashkëpunohet me njësitë qeverisjes vendore dhe ZVRPP dhe të veprohet sipas kërkesave të nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, mars 2014.

b- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë edhe për periudhën në vazhdim, për çdo rast të ndërtimeve informale që shtrihet jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara, të llogarisë detyrimin për pagesë në sipërfaqet e poseduara të parcelave mbi 500 m², me çmimet e tregut në zbatim të nenit 17, pika 1, e ligjit nr 9482 datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje”.

c- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë të rakordojë me 5 bashkitë dhe 16 komunitat e qarkut Lezhë, për pronat e paluajtshme (troje e ndërtesa) të kaluara në inventarë pronësie të njësive të qeverisjes vendore me vendime të Këshillit të Ministrave, për të shmangur përplasjet mes vendimeve të Këshillit të Ministrave, Janar 2014

d- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t të Qarkut Lezhë, për 663 raste aplikimesh të cilat i përkasin ndërtesave pa leje në zonën arkeologjike dhe zona bregdetare, për të cilat nuk është plotësuar aktkualifikimi dhe janë jashtë zonave, objekt veprimi i ligjit të skualifikohen (të përjashtohen nga legalizimi) në zbatim të VKM nr. 515 datë 13.05.2009, “Për përcaktimin afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të

urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, i ndryshuar pika 3.2, shkurt 2014.

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer me zgjedhje të dosjeve për miratimin e lejeve të legalizimit për vitin 2014, u konstatua se në **11 raste**, sipas regjistrit të parcelës ndërtimore, është miratuar sipërfaqja e parcelës ndërtimore në llojin e pasurisë “Truall”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës, në mungesë të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t’i dhënë lejen, veprimin të kryer për legalizim në zonat “*Territore të tjera*”. Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve e dokumentacionit për propozimin e miratimin e zonave informale.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Lezhë, të marrë masa për përcaktimin e statusit juridik për ndryshimin e zërit kadastral, dhe problematika të tjera të trajtuara sipas dosjeve nr. 1757, nr. 35, nr. 252, nr. 436, nr. 31, nr. 2303, nr. 502, nr. 683, nr. 652, nr. 166, nr. 1240, nr. 166, nr. 719.

3. Gjetje nga auditimi: Në **2 raste** janë miratuar leje legalizimit për vitin 2014, me mangësi dhe konkretisht:

- dosja nr. 052, për objekt: Godinë Banimi 1 kat, ZK nr. 8632, nr. Pasurie 10/366, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 210 m², sipërfaqe e ndërtimit 103.3 m², ndërkohë sipas shkresës së Bashkisë Lezhë nr. 3591/1, datë 29.07.2014, pasuria 10/366, ka qenë aset i Bashkisë Lezhë, por duke qenë se në kushtet aktuale, nuk ekziston më ndërtesa e vjetër, pasi aty është ngritur një ndërtesë pa leje nga z. P.J;

Në lidhje me këtë pronë që ka qenë aset i bashkisë, megjithëse bashkia e ka pas përfshirë në inventarin e pronave, ka lejuar shkresëstrisht legalizimin pa bërë vlerësimin e objektit sipas vleftës së inventarit në kontabilitet

- dosja nr. 118, për objekt: godinë banimi 1 kat, ZK nr. 8632, nr. pasurie 10/308, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 168 m², sipërfaqe e ndërtimit 92.67 m², në bazë të VKM nr. 611, datë 11.06.2009, tek leja e legalizimit është shënuar sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 106.32 m², ndërkohë që sipas VKM është miratuar 92.67 m², pra më tepër 13.65 m² se miratimi i VKM.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, të marrin masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës së ish objektit ekzistues pasuria 10/366, ndodhur në ZK nr. 8632 qyteti Lezhë, si dhe të kërkojë pranë ZVRPP kufizimin e pasurisë nr. 10/308, që i përket dosjes nr. 118, ndodhur në ZK nr. 8632 qyteti Lezhë, deri në kryerjen e pagesës dhe prona ti kalojë qytetarit, në rast se nuk ka probleme të tjera me Bashkinë.

4. Gjetje nga Auditimi: Në **32 raste**, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“*vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi*” si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –“ c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë NJQV vetëm shkresën për llogaritjen e pagesën e

taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'ju kërkojë NJ.Q.V. vërtetimin mbi likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, dhe konkretisht për dosjet e legalizimit si më poshtë: dosja nr. 23, datë 05.08.2006; dosja nr. 336, datë 28.08.2006; dosja nr. 3023, datë 17.11.2014; dosja nr. 22, datë 04.06.2006; dosja nr. 1038, datë 24.09.2014; dosja nr. 197/2, datë 10.03.2005; dosja nr. 1032, datë 24.09.2014; dosja nr. 1505, datë 03.10.2014; dosja nr. 16, datë 08.03.2005; dosja nr. 2043, datë 18.07.2013; dosja nr. 877, datë 03.07.2013; dosja nr. 806, datë 02.07.2013; dosja nr. 263, datë 11.09.2014; dosja nr. 275/3, datë 04.03.2005; dosja nr. 4425, datë 19.12.2014; dosja nr. 1833, datë 22.08.2006; dosja nr. 883, datë 03.07.2013; dosja nr. 450, datë 20.06.2013; dosja nr. 1451, datë 01.10.2014, dosja nr. 1462, datë 02.10.2014, dosja nr. 20, datë 11.06.2013; dosja nr. 3/35, datë 09.09.2006; dosja nr. 215, datë 17.06.2013; dosja nr. 2023, datë 18.07.2013; dosja nr. 2783, datë 27.10.2014; dosja nr. 1278, datë 01.10.2014; dosja nr. 32, datë 02.11.2006; dosja nr. 163, datë 03.10.2006; dosja nr. 172, datë 14.06.2013; dosja nr. 1217, datë 10.07.2013; dosja nr. 1442, datë 01.10.2014; dosja nr. 3285, datë 02.12.2014.

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer, u konstatua se ka objekte informale, të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim, duke mos zbatuar procedurat për skualifikimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pikën 5 të nenit 2 dhe nenin 39-*Përjashtimi nga Legalizimi*, Kapitulli IV i VKM nr. 280, datë 01.04.2015, urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 ndryshuar me 954, datë 25.11.2015.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa, për të gjitha objektet informale të cilat nuk plotësojnë kriteret për legalizim, të ndiqen procedurat për s'kualifikimin e tyre nga procesi i legalizimit dhe për njoftimin e Njësive të Qeverisjes Vendore (Bashkitë), si ndërtime të paligjshme që nuk përfshihen në legalizim.

6. Gjetje nga auditimi: Në 29 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:

-Në 4 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet, ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në ne një distancë prej **buzës së lumit Drin me pak se 100 metrash** veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", neni 2, pika 5. VKM nr. 280, date 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" pika 4;

- Në 4 raste, janë kryer legalizime të objekteve pran kanaleve kulluese dhe brezit mbrojtës të tyre pa marrë më parë konfirmimin nga autoriteti ujit për respektimin e distancave, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", dhe VKM nr. 280, date 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" pika 4, germa "e";

-Në 4 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët nacionale ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në ne një distancë prej **buzës rrugës nacionale me pak se 30 metrash** veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 39 "Përjashtimi nga legalizimi", -VKM nr. 438, date 28.06.2006 i ndryshuar Kreu I pika 2/b dhe i ç'fuqizuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e

dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” -VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2;

-Në 17 raste, gjithsej për 6736 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll, vreshtë”, zona informale këto të pamiratuara nga KRRTRSH/KKT. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, neni 17 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall”.

6.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

7. Gjetje nga auditimi: Kërkesa mbi statusin juridik të pronës nuk është i plotë, pasi nuk kërkohet informacion mbi të gjithë kufitarët e pronës që i nënshtrohet procesit të legalizimit dhe ky i pashoqëruar me hartën treguese dhe në 60% e rasteve është operuar me statuse të vjetra (*mbi 3 muaj*), duke mos marrë informacion të freskët për statusin juridik të pronës, nëse ato mund të kenë pësuar ndryshime në kohe, volum dhe pronësi. Gjithashtu, ka dhe raste ku vijimi i procedurave të legalizimit është kryer pa marrë konfirmim mbi statusin juridik të pronës (*në dosje nuk ka informacion*), veprime të cilat janë në kundërshtim me germën “d” e nenit 27, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, i ndryshuar, VKM nr. 258, datë 04.05.2007 "Për regjistrimin fillestar të pasurisë që legalizohet", Memorandumit të Mirëkuptimit e Bashkëpunimit datë 26.07.2007, VKM Nr. 688, datë 29.7.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 332, datë 12.3.2008 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, të përfutur nga fotografimi ajror, digjital i territorit të Republikës së Shqipërisë”, germën “h” të pikës 1, të Urdhrit nr. 46, datë 08.11.2006, Urdhrit nr. 195, datë 26.03.2012 “Për miratimin e manualit mbi mënyrën e plotësimit dhe administrimit të lejes së legalizimit”, si dhe udhëzimin nr. 958, datë 18.12.2012 “Për mënyrën e hartimit, paraqitjen dhe përmbajtjen e dokumentacionit tekniko-ligjorë për propozimin e kalimit të së drejtës së pronës mbi parcelën ndërtimore të objektit informal dhe kompensimit financiar të pronarëve.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa që të mos përsëris rastet e legalizimit pa marrë konfirmimin mbi statusin juridik të pronës brenda afatit 3 mujor nga momenti i kualifikimit të dosjes.

8. Gjetje nga auditimi: Në 23 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi*

- Në 5 raste, mungojnë dokumentet që të vërtetojnë nëse objekti është ndërtuar para vitit 1993, apo me leje ndërtimi pas këtij viti, veprim në kundërshtim me nenin 36, të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të

ndryshuar. Gjithashtu, mungojnë deklaratat noteriale, ku projektuesi i licencuar i konstruksionit të ndërtimit, zbatuesi dhe investitori garantojnë së bashku qëndrueshmërinë konstruktive të objektit në legalizim, të shoqëruar me oponencën e institucioneve të specializuara, të përcaktuar sipas urdhrin të ministrit, që mbulon veprimtarinë e planifikimit të territorit, veprime në kundërshtim me nenin 37, të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

- **Në 17 raste** u konstatua se nuk administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit dokumentacioni i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, për të plotësuar kushtet për fillimin e procedurave të legalizimit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1, VKM Nr. 589, datë 10.9.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale” pika 3.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa që të administrojë në 23 praktikat dokumentare të legalizimit të konstatuara në auditim, dokumentacionin i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, si dhe dokumentacioni që vërteton qëndrueshmërinë e objektit të legalizuar, në të kundërt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

9. Gjetje nga auditimi: Në 14 raste “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. **Në të gjitha rastet** e audituara në genplan nuk pasqyrohen hyrjet në objekt, veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa që për 14 rastet e konstatuara të plotësohet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesës në ndërtimin me leje”, me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve si dhe hyrjet në objekt. Në rastin e mos plotësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

10. Gjetje nga auditimi: ALUIZNI Lezhë nuk ka administruar dhe mbajtur një evidencë të saktë apo regjistër për shkresat e dërguara në ZVRPP Lezhë në lidhje me statusin e parcelave mbi të cilat janë ngritur ndërtimet pa leje, por shkresat administrohen bashkërisht me shkresat e tjera, nuk është caktuar me rregullore një person i caktuar i cili duhet të mbajë evidencat për marrëdhëniet ALUIZNI-ZVRPP, të cilat do të shërbejnë procesit të legalizimit në vazhdimësi

10.1. Rekomandim: Drejtoria ALUIZNI Lezhë të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme për shkresat në lidhje me statutet juridike të pasurive, afatet e trajtimit të tyre, përgjigjet e dhëna nga ZVRPP si dhe problematikat e hasura në vazhdimësi, duke i shërbyer në këtë mënyrë mbarëvajtjes së procesit të legalizimit.

11. Gjetje nga auditimi: Në disa raste nuk është bërë dorëzimi dhe marrja e detyrës me procesverbal në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13, çka ka sjellë si pasojë mungesën e një informacioni të saktë ndër vite për procesin e legalizimit.

11.1. Rekomandim: Drejtoria ALUIZNI Lezhë të marrë masa që në çdo rast të marrjes dhe dorëzimit të detyrës nga punonjësit të mbahet procesverbal në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Institucionit si dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13.

12. Gjetje nga auditimi. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, nuk ka administruar dhe mbajtur një regjistër të veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve ndër vite, nuk ka një evidencë të saktë për numrin e ankesave të bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit të tyre si dhe zgjidhjen e problemit. Titullari i Institucionit nuk ka ngarkuar me urdhër të veçantë një person kompetent apo një grup specialistësh për shqyrtimin e ankesave, gjithashtu në asnjë nga dokumentet e punës të paraqitura për auditim nuk është adresuar përgjegjësia për shqyrtimin e ankesave, por ato i janë adresuar specialistëve përkatës rast pas rasti sipas problematikave, kryesisht Sektorit të Legalizimit dhe të Hartografisë, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale i ndryshuar, dhe VKM-ve, urdhrave dhe udhëzimeve të dala në zbatim të këtij ligji, si dhe Ligjit nr. 44/2015-Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" .

12.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa, për të krijuar një regjistër të veçantë për administrimin e ankesave, afatet e shqyrtimit të tyre, bazueshmërinë ligjore për zgjidhjen e tyre duke krijuar në këtë mënyrë një praktikë më vete shkresore për çdo ankesë, në përputhje me dispozitat të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale i ndryshuar, dhe VKM-ve, urdhrave dhe udhëzimeve të dala në zbatim të këtij ligji. Ligji nr. 44/2015-Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Gjithashtu Titullari i Institucionit të caktojë, me urdhër një grup të veçantë për shqyrtimin e ankesave, ku në përbërje të së cilit të ketë domosdoshmërisht një jurist dhe një specialist të Sektorit të Legalizimeve dhe Hartografisë.

13. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste për subjektet G.Z.M, dosja nr. 2590, datë 16.10.2014, dhe Y. A. K nr. 3285, datë 02.12.2014, ka rezultuar se në llogaritjen e vlerës për pagesën e parcelës ndërtimore është zbritur 10% për pagesën vjetore të energjisë elektrike në vlerë totale **39,000 lekë**, përkatësisht sipas subjekteve G.Z.M **28,000 lekë** dhe Y.A.K **11,700 lekë**, por në dosje nuk ka asnjë dokument që vërteton pagesën, në kundërshtim me kërkesat e VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës, pika 11 “ *Si garanci për shlyerjen e detyrimeve vjetore kontraktore të furnizimit me energji elektrike mbi vlerën e mbetur të parcelës ndërtimore të objektit pa leje aplikohet një zbritje prej 10%. Nëse subjekti*

dëshmon se, brenda një viti nga data e njoftimit mbi pagesën e parcelës ndërtimore, ka kryer rregullisht shlyerjen e detyrimeve të furnizimit me energji elektrike, vlera e garancisë falet”.

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa që për subjektet G.Z.M dhe Y.A.K, si dhe për rastet e tjera analoge të kërkojë dorëzimin e vërtetimit për pagesën vjetore të energjisë elektrike, në rast të kundërt të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **28,000 lekë nga subjekti G.Z.M** dhe vlerës **11,700 lekë** nga subjekti Y.A.K.

14. Gjetje nga auditimi: Në 9 raste Drejtoria e ALUIZNI-t Qarku Lezhë nuk ka respektuar afatin 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose skualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, veprime këto në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8 “*Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht”.*

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa që më plane konkrete sipas zonave informale të shqyrtojë kërkesat për të zbatuar afatet ligjore për shqyrtimin e praktikave të legalizimit në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “*Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8*”.

15. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i Evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje” viti 2015* me fond limit 8,000,000 lekë pa TVSH dhe 9,600,000 me TVSH, janë konstatuar mangësitë si vijon:

- Kriteret për kualifikim të përcaktuara nga Njësia e Prokurimit nuk janë të plota, dhe në përputhje me rregullat e prokurimit dhe parimet për konkurrencën e lirë dhe transparencën, duke favorizuar Bashkimin e Operatorëve “E-G” Sh.p.k, “R.S” Sh.p.k, C.E.C Group Sh.p.k dhe “S” Sh.p.k të shpallet fitues në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1-Objekti dhe qëllimi, germa *a, c, d, ç, d, dh*, dhe Neni 46- Kualifikimi i ofertuesve, pika 3.

- Nga dokumentacioni i administruar në praktikë si dhe relacioni i mbajtur për hartimin e fondit limit nuk ka informacion të hollësishëm dhe analitik mbi numrin faktik dhe gjendjen reale të ndërtimeve pa leje sipas zonave dhe vetë deklarimeve të bëra nga individët, për të dhënë një pasqyrë të qartë se sa % të ndërtimeve informale nga sasia totale e ndërtimeve të evidentuara (*ku sipas deklarimeve të bëra deri në vitin 2015 rezultojnë 23274 vetë deklarime*), do të mbulonte ky proces sipas fondit të vënë në dispozicion për vitin 2015.

- Nuk janë respektuar procedurat për shqyrtimin e ankesës të bashkimit të operatorëve ekonomik “I&K” Sh.p.k, në lidhje me dokumentet e tenderit, pasi me urdhër nr. 1422, datë 28.10.2015 të titullarit të Autoritetit Kontraktor është ngarkuar për shqyrtimin e ankesës po Njësia e Prokurimit në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Kreu X, neni 78-Ankesat në autoritetin kontraktor, pika 6 germa “a”

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “E-G” Sh.p.k, “R.S” Sh.p.k, C.E.C Group Sh.p.k dhe “S” Sh.p.k, nuk duhet të shpallet fitues pasi nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në DST-t, KVO-ja duhet të kalonte tek vlerësimi i operatorit të radhës. KVO-ja ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”.

15.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa që në çdo rast në organizimin e procedurave të prokurimit publik hartimi i fondit limit të shoqërohet me dokumentacion justifikues e argumentues; kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit të jenë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës; në

shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomik në lidhje me dokumentet e tenderit të caktohet një komision i ndryshëm nga Njësia e Prokurimit.

16. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i Evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje*” viti 2015 me fond limit 8,000,000 lekë pa TVSH dhe 9,600,000 me TVSH, në fazën e zbatimit të kontratës, janë konstatuar mangësi në procesverbalin e marrjes në dorëzim pasi në përmbajtjen e tij, ashtu si dhe në listën emërore bashkëngjitur nuk ka të përcaktuar se cili nga personat e renditur në listë, ka objekt me më shumë se një kat. Pra, duke mos dhënë një evidencë të saktë nëse kontrata është përmbushur plotësisht, gjithashtu nuk është bërë përshkrimi i detajuar për plotësimin e kriterëve specifike të përcaktuara në DST-të, verifikimin e hartës së parcelës ndërtimore dhe i librit të parcelave ndërtimore nëse janë hedhur të gjitha objektet, si dhe faktit nëse është bërë verifikimi për çdo dosje nga të dyja palët sipas inventarit, në kundërshtim me Nenin 5-Dorëzimi dhe kushtet e dorëzimit të shërbimit të kryer, pika 5.4 dhe Nenin 12, pika 12.2 të kontratës datë 17.11.2015 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 77- Mbikëqyrja e kontratës.

16.1. Rekomandim : Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa, të plotësojë dokumentacionin justifikues sipas listës emërore, kur ka objekt me më shumë se një kat, si dhe në çdo rast të likuidimit të urdhër shpenzimeve të shoqërohen me dokumentacionin argumentues sipas përcaktimeve të bëra në kontratë dhe sipas kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë “Për menaxhimin financiar dhe kontrolli”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 77- Mbikëqyrja e kontratës si dhe VKM nr. 30, datë “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

17. Gjetje nga auditimi: Nga autoriteti kontraktor, Komisioni Prokurimit me Vlera të Vogla në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Lezhë, nuk janë krijuar dosje/praktikë e mirëfilltë dokumentare për çdo procedurë prokurimi, dokumentacioni administrohet bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, ndërkohë që pjesa dërrmuese e dokumentacionit që u vunë në dispozicion për auditim, janë të pa inventarizuara, dhe të pa listuara, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

17.1. Rekomandim : Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa, të krijojë dosje më vetë për çdo procedurë prokurimi, si dhe të inventarizojë dokumentacionin pjesë përbërëse e praktikës në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

18. Gjetje nga auditimi: Programimi dhe evidentimi i nevojave për mallra dhe shërbime nuk është bërë në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së, i detajuar për çdo procedurë, nuk është hartuar regjistri i parashikimeve dhe regjistri i realizimit të prokurimeve, shoqëruar me shkresat përcjellëse brenda afateve ligjore të përcaktuara, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu I, neni 4 dhe neni 7 .

18.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa të hartojë në mënyrë të detajuar dhe sipas afateve ligjore për çdo vit Regjistrin e Realizimit dhe Parashikimit të Prokurimeve Publike në përputhje me nevojave për mallra dhe shërbime.

19. Gjetje nga auditimi: Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, në 17 procedura prokurimi me vlerë të vogël nga 32 të zhvilluara gjatë viteve 2014, 2105 deri në datë 30.09.2016, ka shpallur fitues vetëm tre operatorë ekonomik konkretisht “E.C”, PC Sh.p.k dhe “E.C” , duke mos stimuluar konkurrencën dhe transparencën sipas parimeve të Ligjit nr.

9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 1-Objekti dhe qëllimi dhe Neni 2-Parimet e përzgjedhjes .

19.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa që në çdo rast në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik fitues në blerjet me vlera të vogla të respektojnë parimet transparencës dhe stimulimit të konkurrencës.

20. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast gjatë vitit 2014 është konstatuar se nga Komisioni i Prokurimit me vlera të vogla është vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2- Prokurim me vlerë të vogël, shkronja “a”, pasi për mallra të ngjashëm si orendi dhe pajisje për zyrat janë realizuar 3 procedura prokurimit brenda një periudhe të shkurtër prej një javë, duke copëzuar fondin limit dhe duke kaluar vlerën prej 400,000 lekë, përcaktuar në Udhëzimin nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 28.02.2014, pika 1 dhe pika 3 .

20.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa, që në çdo rast në organizimin e procedurave të prokurimit të shmangë copëzimin e fondit limit për shërbimet dhe mallra të ngjashme si dhe të stimulojë procedurat konkurruese.

21. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Lezhë, në organizimin procedurave të prokurimit me vlerë të vogël nuk është vepruar në përputhje me kërkesat ligjore pasi:

- Në 21 raste me vlerë totale 4,418,314 lekë mungon relacioni apo procesverbali konstatues nga personat kompetent për dëmtimet e ndodhura në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Neni 40-Prokurim me vlerë të vogël, pika 3, dhe UMF, nr. 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” ndryshuar;

- Në 19 raste me vlerë totale 3,652,596 lekë mungon procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, faturat tatimore apo fletë hyrjet nuk janë të detajuara sipas artikujve dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, por vetëm është shënuar sasia totale e mallit dhe vlera përkatëse, në disa raste faturat tatimore nuk janë të firmosura nga të gjithë anëtarët e Grupit të Marrjes në Dorëzim të Mallit, në 7 raste dorëzimi i mallit nuk është shoqëruar me fletë garanci, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 23 “Specifikimet teknike” dhe nenin 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX, Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e 43, 45, 47, 52 dhe 54

- Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, në 8 raste me vlerë totale 1,826,005 lekë ka shpallur fitues operatorët ekonomikë edhe kur nuk kanë plotësuar specifikimet e kërkuara në ftesën për ofertë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 28.02.2014, Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr. 1, datë 21.04.2016 .

21.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa, që për çdo rast procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të shoqërohen me relacion apo procesverbal konstatues nga personat kompetent dhe nga Sektori i Burimeve Njerëzore për dëmtimet e ndodhura, të mbahet procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit dhe shërbimit, i detajuar sipas artikujve dhe specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe dokumentet e tenderit, i firmosur nga të gjitha anëtarët e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Mallit.

22. Gjetje nga auditimi: Në 6 raste procedurat e prokurimit në sistemin elektronik nuk janë të rregullta pasi nuk janë hedhur njoftimet për skualifikimin dhe shpalljen fitues në rastet kur operatorët e radhës kanë hequr dorë nga konkurrimi, nuk janë respektuar afatet për publikimin e njoftimit të fituesit, si dhe nuk është bërë arkivimi i kontratës në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 4, datë 04.07.2013 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”, i ndryshuar me Udhëzim nr. 03, datë 03.04.2014 si dhe Udhëzimin Nr. 5, datë 27.01.2015 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”, gjithashtu dhe Udhëzimet nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 28.02.2014, Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr. 1, datë 21.04.2016.

22.1. Rekomandim : Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, Njësia e Prokurimit të marrë masa, që për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në sistemin elektronik të shpallen njoftimet për skualifikimin dhe shpalljen fitues në rastet kur operatorët e radhës kanë hequr dorë nga konkurrimi, të respektohen afatet për publikimin e njoftimit të fituesit si dhe të bëhet arkivimi i kontratës.

23. Gjetje nga auditimi: Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, në 5 raste në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat, ka kërkuar llojin i markës, pa shënimin e detyrueshëm “ose ekuivalent” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5 .

23.1. Rekomandim : Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, Njësia e Prokurimit të marrë masa, që për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, kur për një mall të caktuar kërkohet lloji i markës të vendos shënimin e detyrueshëm “ose ekuivalent” në përputhje me kërkesat Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5.

24. Gjetje nga auditimi: Në 18 raste në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, me vlerë totale 4,445,188 lekë nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit dhe në 8 raste procesverbal për testimin e tregut, në 16 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2- Llogaritja e vlerës së kontratës, shkronja “c” dhe “ç”, Kreu VI, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël”, shkronja “b”, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu IV, neni 40, Kreu VII, neni 59 si dhe UMF, nr. 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, ku është përcaktuar se: “Kërkuesi i shërbimit bën kërkesë për prokurime me vlerë të vogël brenda limitit të përcaktuar nga ligji së bashku me specifikimet teknike, kriteret për përzgjedhjen e fituesit, afatin kohor për dorëzimin e propozimeve dhe kushtet kryesore të kontratës”.

24.1. Rekomandim : Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, Njësia e Prokurimit të marrë masa që për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të shoqërohen me relacion apo procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit, procesverbal për testimin e tregut, në rastet ku është e nevojshme, si dhe kërkesat nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime.

25. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, nuk ka ndjekur procedurat të sakta dhe të rregullta për marrjen me qira të ambienteve për zyra, procedurat e zhvilluara në disa raste janë fiktive dhe ka munguar konkurrimi, mungon certifikata e pronësisë për pasuritë e marrë me qira. Në total për 3 vite për marrjen e ambienteve me qira nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, janë shpenzuar 2,246,400 lekë, të cilat

nëse do të përdoreshin me efektivitet duke u investuar në një formë tjetër për ndërtimin një objekti, do të rritej vlera e investimit dhe vlera e aktiveve të zotëruara nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, si dhe pasuria do të administrohej si aset në pronësi të institucionit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Kreu IV- “Marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë”, neni 27, neni 31, pika 2, neni 32 dhe 33 si dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42, 43, 45 47, 52 dhe pika 54 .

25.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa, të menjëhershme të plotësojë praktikën për kontratat e marrjes me qira të ambienteve për nevoja për zyra, me dokumentacionin shoqërues tekniko-ligjor, si dhe në çdo rast të zbatojë procedurat për marrjen me qira sipas kërkesave të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 për “Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Kreu IV-“Marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë”.

26. Gjetje nga auditimi: Në total për 3 vite për marrjen e ambienteve me qira nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, janë shpenzuar 2,246,400 lekë, të cilat nëse do të përdoreshin me efektivitet duke u investuar në një formë tjetër për ndërtimin një objekti, do të rritej vlera e investimit dhe vlera e aktiveve të zotëruara nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, si dhe pasuria do të administrohej si aset në pronësi të institucionit, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42, 43, 45 47, 52 dhe pika 54.

26.1. Rekomandim : Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë të marrë masa për përdorimin me efektivitet të fondeve publike duke rritur vlerën e investimit dhe të aktiveve të zotëruara nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, duke administruar pasurinë si aset në pronësi të institucionit, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42, 43, 45 47, 52 dhe pika 54.

27. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi dhe verifikimi i ankesës së shtetasit D.D datë 01.12.2016, në lidhje me ndërtimin pa leje të ngritur në vitin 2011, në Adriatik, Komuna Fushë-Kuqe, i vetë deklaruar nga shtetasi M.C.D sipas dosjes nr. 4939, datë 24.12.2014, **rezulton :**

Së pari: - Objekti ndodhet në zonë turistike dhe në zonë të mbrojtur ku shkalla e mbrojtjes nuk lejon ndërtime sipas kërkesave të VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “e”, si dhe VKM nr. 995, datë 03.11.2010 “Për shpalljen “Rezervat natyror i menaxhuar” të ekosistemit natyror ligatinor të Patok-Fushë-Kuqe-Ishëm. pika 4, germa-b.

Së dyti: - Nga verifikimi i regjistrat dixhital të deklarimeve administruar në ZVRPP Lezhë dhe i aksesueshëm online në faqen zyrtare të ALUIZNI, rezulton se me numër rendor 4939 është regjistruar vetë deklarimi me nr. 4939, datë 24.12.2014 nga shtetasi M.C.D. Ky regjister është përcjellë fizikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI Tiranë me shkresën nr. 120 prot, datë 05.02.2015, me lëndë dërgim dokumentacioni, bashkëlidhur janë dërguar gjashtë regjistrat manual si dhe regjistri në format dixhital të deklaratave të mbajtura për deklaratimet e vitit 2014-2015 nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë. Gjithashtu në dosje administrohet certifikata familjare e cila është lëshuar në datën 24.12.2014, pra përkon me datën e deklaratimit. Sa sipër rezulton se vetë deklarimi është brenda afati ligjor të përcaktuar në Udhëzimin nr. 767, datë 10.09.2014 “Për miratimin e formës, mënyrës së plotësimin dhe administrimit të deklaratës për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimeve pa leje”,

afati i zgjatur më pas deri në datë 31.12.2015 me Udhëzimin nr. 432, datë 26.12.2014, për një ndryshim në Udhëzimin nr. 767, datë 10.09.2014. Me Udhëzimin nr. 969, datë 15.07.2015 është shfuqizuar Udhëzimin nr. 767, datë 10.09.2014, dhe ka ndryshuar afati i deklarimit nga data 31.12.2015, është bërë deri në datën 30.09.2015.

Së treti: - Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se nuk janë zbatuar procedurat administrative në përpilimin e akteve të ndërmjetme procedural sipas afateve ligjore, nuk është respektuar afati prej 60 ditësh nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren deri në marrjen e Vendimit për kualifikimin ose jo të objektit në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8. *Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht, mungon dokumenti/imazhi që vërteton vitin e ndërtimit të objektit, mungon vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, mungon shkresa për miratimin e ndryshimit të zërit kadastral duke qenë se është zonë informale, akti për vlerësimin e ndikimit në mjedis si dhe miratimi nga organet kompetente, procesverbalit të konstatimit në terren i mungon nënshkrimi nga specialistët kompetent, Sektori i Hartografisë nuk ka kryer azhurnimin e objektit në hartë, si dhe nuk ishte paguar tarifa e shërbimit në vlerë 8 000 lekë si objekt shërbimi në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 2.*

27.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, Sektori i Hartografisë dhe i Legalizimit, referuar detyrës funksionale dhe në zbatim të ligjshmërisë, rregullshmërisë, kriterëve, procedurave dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të zbatueshëm për ndërtimin pa leje, të marrë masa për mbajtjen e akteve administrative të ndërmjetme dhe marrjen e vendimit të skualifikimit, për këtë dosje në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “e”, si dhe VKM nr. 995, datë 03.11.2010 “Për shpalljen “Rezervat natyror i menaxhuar” të ekosistemit natyror ligatinor të Patok-Fushë-Kuqe-Ishëm. pika 4, germa-b.

PËR DREJTORINË E ALUIZNI-T TIRANA 4

28. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi dhe verifikimi i *praktikës shkresore* të administruar në Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë (pasi dosjet nr. 27 prot, datë 10.09.2014 dhe nr. 41 prot, datë 10.09.2014 të vetë deklaruara nga z. I.Z.D, ndodhen fizikisht në Drejtorinë nr. 4, ALUIZNI Tiranë si objekte të ndërtuara në zona turistike), në lidhje me ankesën e shtetasit D.D datë 01.12.2016, ka rezultuar se veprimi i vetë deklarimit të ndërtimeve pa leje në datë 10.09.2014 ka ndodhur më pas në kohë nga veprimi i konstatimit në terren nga INUV, Qarku Lezhë të dy objekteve pa leje në posedim të I.D për të cilat është mbajtur procesverbali i konstatimit datë 12.09.2013. Ndërkohë që me datë 13.09.2013 është marrë vendimi për prishje të 2 objekteve 1 kat dhe 2 kat, por Qarku Lezhë nuk ka disponuar mjete për ekzekutimin e vendimit. Pra Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar nuk ka vepruar për prishjen e ndërtimeve pa leje gjatë periudhës 13.09.2013-10.09.2014, për gati një vit në kundërshtim me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, Neni 9 dh Neni 10 dhe 10/1 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe sipas periudhës Ligjin nr. 10119, date 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar, Neni 80 dhe 81 dhe Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Sa sipër objektet pa leje në posedim të shtetasit I.D nuk duhet t'i nënshtroheshin procesit të legalizimit pasi për to ka një vendim prishje të INUV, Qarku Lezhë me datë 13.09.2013.

28.1. Rekomandimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 (që shqyrton pjesët e legalizimit në zonat e turistike) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, referuar detyrës funksionale dhe në zbatim të ligjshmërisë, rregullshmërisë, kritereve, procedurave dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të zbatueshëm për ndërtimin pa leje, të marrë masa të menjëhershme për mbajtjen akteve administrative të ndërmjetme dhe marrjen e vendimit të skualifikimit për dosjet nr. 27 prot, datë 10.09.2014 dhe nr. 41 prot, datë 10.09.2014 të vetë deklaruara nga z. I.Z.D, që ndodhen fizikisht në Drejtorinë nr. 4, ALUIZNI Tiranë, si objekte të ndërtuara në zona të mbrojtura, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", pika 2, germa "e".

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **69 raste me vlerë 5,884,616 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në **30 raste legalizimi** del se nuk është llogaritur penalteti, pra mos zbatim i kërkesave të neneve 7 "Vetëdeklarimi" dhe nenit 8 "Sanksionet e zbatueshme për mosrespektim afati të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, që shprehin:

Neni 7 "Vetëdeklarimi", të gjitha subjektet që disponojnë ndërtime pa leje janë të detyruara që, duke filluar nga 60 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, t'i vetëdeklarojnë ato (objektin pa leje dhe parcelën ndërtimore) pranë zyrës së urbanistikës të njësisë përkatëse.

Neni 8 "Sanksionet e zbatueshme për mosrespektim afati":

Kur vetëdeklarimi nuk kryhet brenda afateve ligjore të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 7 të këtij ligji, vendoset kjo masë gjobe:

I. Për "vendbanimet informale" dhe "territore të tjera":

- a) brenda muajit të tretë, vetëdeklarimi shoqërohet me gjobë 10 lekë për metër katror sipërfaqe toke të zënë, nga data 16 shtator deri 15 tetor 2006;
- b) brenda muajit të katërt, vetëdeklarimi shoqërohet me gjobë 20 lekë për metër katror sipërfaqe toke të zënë, nga data 16 tetor deri 24 nëntor 2006;
- c) në përfundim të afatit të vetëdeklarimit subjektit i humb e drejta e legalizimit, konstatohet **një dëm ekonomik prej 182,200 lekë**.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë, të marrin masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës së penalteteve të llogaritura, në **30 raste me vlerë 182,200 lekë** dhe konkretisht

1. L.L, pasuria nr. 56/100 me vlerën 6,700 lekë,
2. F.T, pasuria nr. 85/200 me vlerën 7,600 lekë,
- 3.K.M, pasuria nr. 141/300 me vlerën 7,100 lekë,
4. P.V, pasuria nr. 4/100 me vlerën 9,100 lekë,

5. A.GJ, pasuria nr. 84/117 me vlerën 6,800 lekë,
 6. N.M, pasuria nr. 43/102 me vlerën 10,000 lekë,
 7. Z.D, pasuria nr. 34/100 me vlerën 9,600 lekë,
 8. A.P, pasuria nr. 339/412 me vlerën 7,400 lekë,
 9. GJ.M, pasuria nr. 4/108 me vlerën 8,500 lekë,
 10. Xh.L, pasuria nr. 22/102 me vlerën 4,100 lekë,
 11. F.N, pasuria nr. 53/129 me vlerën 8,200 lekë,
 12. K.V, pasuria nr. 99/100 me vlerën 5,600 lekë,
 13. N.P, pasuria nr. 117/121 me vlerën 7,500 lekë,
 14. Gj.L, pasuria nr. 114/107 me vlerën 3,400 lekë,
 15. M.N, pasuria nr. 4/127 me vlerën 3,000 lekë,
 16. Q.M, pasuria nr. 233/109 me vlerën 6,600 lekë,
 17. P.N, pasuria nr. 141/126 me vlerën 6,300 lekë,
 18. F.L, pasuria nr. 49/102 me vlerën 7,100 lekë,
 19. J.K, pasuria nr. 26/127 me vlerën 6,800 lekë,
 20. M.M, pasuria nr. 340/539 me vlerën 7.600 lekë,
 21. P.P, pasuria nr. 210/102 me vlerën 2,800 lekë,
 22. S.P, pasuria nr. 210/104 me vlerën 2,900 lekë,
 23. Z.S, pasuria nr. 8/102 me vlerën 6,000 lekë,
 24. P.P, pasuria nr. 26/129 me vlerën 6,800 lekë,
 25. Gjoke Marku, pasuria nr. 357/164 me vlerën 6,800 lekë,
 26. B.J, pasuria nr. 4/321 me vlerën 6,000 lekë,
 28. Ll.Ll, pasuria nr. 30/124 me vlerën 5,900 lekë,
 29. K.P, pasuria nr. 209/13 me vlerën 4,500 lekë
 30. A.Z, pasuria nr. 211/103 me vlerën 3,100 lekë,
- Në të kundërt zhdëmtimi të bëhet nga shkaktarët.

2. Gjetje nga auditimi: Në **14 raste legalizimi**, nuk ndodhen në dosje dokumentet për likuidimin e taksës së infrastrukturës, në kundërshtim me pikën “ç”, të nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar që shpreh: ç) vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi dhe dokumentet e pagesës për tarifën e shërbimit, në kundërshtim me nenin 24, pika “ë” të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dokumente të cilët nuk ishin inventarizuar apo arkivuar në dosje dhe në protokollin e institucionit, mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”, ku nga mos llogaritja dhe mos arkëtimi i taksës së infrastrukturës, konstatohet **një dëm ekonomik prej 477,687 lekë**.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Lezhë, të marrin masa duke ndjekur rrugët ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së taksës së infrastrukturës, si dhe dokumentacionin për tarifën e shërbimit, në **14 raste me vlerë 477,687 lekë**, prej të cilave dosja 997, subjekti informal “P.B” 49,500 lekë, “P.P, për 16,725 lekë; “Xh.Gj”, për 29,648 lekë “E.D”, për 35,074 lekë; “A.K.”, për 32,853 lekë; “V.K”, për 54, 715 lekë; “L.L, për 18,254 lekë; “F.T për 20,512 lekë; “K.M”, për 19,259 lekë; “P.V”, për 26,009 lekë; “A.P”, për 60,242 lekë; “Gj. M”, për 37,324 lekë; “K.P”, për 15,635 lekë dhe dosja 75 “A.Z” 41,237 lekë.

3. Gjetje nga auditimi: Në **9 rast**, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 43, pika 1, pasi nuk janë zbatuar penalitetet për legalizimin e shtesave dhe si rrjedhojë në përputhje e në zbatim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, si dhe Udhëzimi i Këshillit të

Ministrave nr. 2, datë 06.08.2014 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014”, është shkaktuar **një dëm buxhetit të shtetit për fondin e kompensimit në shumën 1,930,208 lekë**.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrin masa, duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës së penaltit për legalizimin e shtesave prej **1,930,208 lekë**, konkretisht personat: L.K në shumën 449,231 lekë; A.K në shumën 288,046 lekë; P. L në shumën 164,715 lekë; P.Rr në shumën 134,774 lekë; YY.A.K në shumën 56,132 lekë; Z.P.H në shumën 206,690 lekë; N.LL.T në shumën 280,745 lekë; A.H.M në shumën 139,799 lekë; F.R.GJ në shumën 212,076 lekë.

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i Evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje*” viti 2015 me fond limit 8,000,000 lekë pa TVSH dhe 9,600,000 me TVSHu konstatua se procedura që në fazën e hartimit të fondit limit është e gabuar pasi tarifa e evidentimit në terren të objekteve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje për një kat është përcaktuar 8000 lekë pa TVSh dhe 9600 lekë me TVSH, ndërkohë që referuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*”, pika 2. Tarifa e shërbimit për legalizim, për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, si dhe për objektet e dyta, në kuptim të nenit 25, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, **është 8000 (tetë mijë) lekë, për çdo kat të ndërtimit**. Autoriteti Kontraktor që në fazën e hartimit të fondit limit duhet të përcaktonte tarifën maksimale të ofrimit të shërbimit çmimin 8000 lekë, bashkë me TVSh të përfshirë (tarifë e cila paguhet dhe nga qytetarët) dhe brënda këtij çmimi maksimal operatorët duhet të konkuronin duke ofruar çmimet me të ulëta se çmimi 6666 lekë pa TVSh. Për pasojë diferenca prej **439,680 lekë** (8,384 lekë çmimi me TVSh i ofruar nga fituesi – 8000 lekë çmimi tavan bashkë me TVSH që nuk duhet kalohej referuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014), **përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **439,680 lekë** e përfituar padrejtësisht nga bashkimi i operatorëve ekonomik “E–G” Sh.p.k, “R..S” Sh.p.k, C. .C Group Sh.p.k dhe “S...” Sh.p.k, në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*”, pika 2, ku tarifa e shërbimit për legalizim është përcaktuar është 8000 (tetë mijë) lekë, për çdo kat të ndërtimit.

5. Gjetje nga auditimi: Në **2 raste** operatorët ekonomikë “L... Sh. p. k”, për vitin 2016 dhe D&J Sh. p.k për vitin 2015, si rezultat i llogaritjes gabim të çmimit të karburantit kanë përfituar padrejtësisht shumën **90,270 lekë**, e cila **përbën dëm ekonomik**, në kundërshtim me përcaktimet e ftesës për ofertë ku citohet se: “...Çmimi i mallrave do të jete sipas cmimit të tregut në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, çmimi i bursës, sipas Reuters levruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike...”, si dhe kontratën nr. 522 prot, datë 18.02.2016, Nenin 3-Çmimi i kontratës dhe kontratën nr. 1459 prot, datë 02.01.2015, Neni 3-Çmimi i kontratës.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **90,270 lekë**, të përfituar padrejtësisht si rezultat i llogaritjes gabim të çmimit të karburantit në kundërshtim me përcaktimet e ftesës dhe kontratën nr. 522 prot, datë 18.02.2016, Nenin 3-Cmimi i kontratës dhe kontratën nr. 1459 prot, datë 02.01.2015, Neni 3-Cmimi i kontratës, përkatësisht si më poshtë:

a- Operatori ekonomik “L....-80 Sh.p.k”, për vlerën **49,590 lekë**

b- Operatori ekonomik **D... Sh.p.k**, për vlerën **40,680 lekë**.

6. Gjetje nga auditimi: Në **dy raste** në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, është likuiduar urdhër shpenzimi nr. 10, datë

20.02.2014, me objekt shpenzimi “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës (bojë printeri)” në shumën 10,000 lekë pa TVSh, dhe objekt shpenzimi “Materiale të tjera për zyra (letër A3)” në shumën 10,000 lekë pa TVSh tek subjekti kancelari “K...” Lezhë, i pashoqëruar me faturë tatimore nga subjekti që ka përfituar shumën në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42, 43, 45 47, 52 dhe pika 54, për pasojë likuidimi **prej 20,000 lekë** është i pajustificuar dhe përbën dëm ekonomik .

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **20,000 lekë**, si likuidim i pa justifikuar dhe i pa shoqëruar me faturë tatimore kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42, 43, 45 47, 52 dhe pika 54, nga ish-Përgjegjësi i Sektorit të Financës z. L.Z.

7. Gjetje nga auditimi: Në një rast për praktikën e legalizimit në emër të K.R.U, dosja nr. 163, datë 03.10.2006, Leje legalizimi nr. 11107, datë 19.02.2015, për objektin “*Godinë Shërbimi 1 Kat*”, ka rezultuar se sipas procesverbalit të konstatimit në terren, vendimit të kualifikimit, si dhe lejes së legalizimit objekti është përcaktuar për shërbim dhe jo banesë, ndërkohë që referuar formularit të pagesës për parcelën ndërtimore llogaritja, është bërë si banesë dhe jo objekt shërbimi në kundërshtim me VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës, Kreu I, pika 1 dhe 2, **duke ju shmangur padrejtësisht pagesës së vlerës 443,600 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për fondin e kompensimit.**

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa që në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës, Kreu I, pika 1 dhe 2, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **443,600 lekë** nga subjekti K.R.U, ardhur si pasojë e llogaritjes gabim të tarifës së parcelës ndërtimore.

8. Gjetje nga auditimi: Në një rast për praktikën e legalizimit në emër të F.R.Gj, dosja nr. 172, datë 14.06.2013, Leje legalizimi nr. 816284, datë 03.10.2016, për objektin “*Shtesë anësore 4 Kat dhe në lartësi 2 Kat në objektin ekzistues 2 Kat*”, ka rezultuar se nuk është llogaritur saktë vlera për parcelën ndërtimore, ku në total subjekti duhet të paguante vlerën 190,098 lekë (95,049 në lekë dhe 95,049 në Bono), për pasojë i është shmangur pagesës së **vlerës 59,298 lekë (19,049 në Bono dhe 40,249 në lekë), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për fondin e kompensimit .**

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa që në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës, Kreu I, pika 1 dhe 2, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **59,298 lekë** nga subjekti F R Gj, ardhur si pasojë e llogaritjes gabim të tarifës së parcelës ndërtimore.

9. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste për subjektet G.J.M.P, K.R.U, Z.M.M, nuk është aplikuar kamat vonesa në **vlerë 11,046 lekë** dhe një rast për subjektin M D tarifa e shërbimit në vlerë **8000 lekë** për aplikim e vonuar në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, Neni 8 -Sanksionet e zbatueshme për mosrespektim afati, pika a) brenda muajit të tretë, vetë deklarimi shoqërohet me gjobë 10 lekë për metër katror sipërfaqe toke të zënë; dhe b) Brenda muajit të katërt, vetë deklarimi shoqërohet me 20 lekë gjobë për metër katror sipërfaqe tokë të zënë dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për

përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 2.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa duke kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **11,046 lekë** nga subjektet Gj.M.P (2900 lekë), K.R.U (606 lekë), Z.M.M (7540 lekë), dhe nga subjekti M.D vlerën **8000 lekë**, ardhur nga mos pagesat e kamatëvonesave në deklaram dhe tarifës së shërbimit në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, Neni 8 - Sanksionet e zbatueshme për mosrespektim afati, pika a) dhe b) si dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 2.

10. Gjetje nga auditimi:Në **2 raste**, janë legalizuar ndërtimet pa leje në sipërfaqe tokë shtetërore dhe publike, duke lidhur kontrata për shitjen e parcelave ndërtimore me parcelën ndërtimore prej 500 m² e cila është më shumë se tre fish i sipërfaqes së ndërtimit.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 3, pika f dhe 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, për sipërfaqen e përgjithshme prej **331.40 m²** me një vlerë të përgjithshme prej **452,721 lekë**, e ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për llogari të fondit të krijuar për kompensimin e ish-pronarëve.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa dhe të ndjek procedurat administrative, duke iniciuar me poseduesit e parcelës ndërtimore për korrigjimin e kontratave të shitjes së truallit në 2 raste me sipërfaqen **331.4 m²**, për të cilën është arkëtuar më pak vlera prej **452,721 lekë**, duke bashkëpunuar me NJQV dhe ZVRPP-në konkretisht për dosjet e legalizimit dosja nr. 1038, datë 24.09.2014; dosja nr. 806, datë 02.07.2013.

11. Gjetje nga auditimi: në **1 rast** për dosjen me vetëdeklarim nr. 252, datë 22.03.2005, është paguar vlefëta për 300 m² nga 500 m² që ka marrë sipas kontratës së kalimit të pronësisë, nr. 641 rep dhe nr. 344 kol, datë 23.04.2014 për pasurinë nr. 12/414, duke u krijuar një dëm me vlerën 1,702,200 lekë (200 m² x 8511 lekë/m²), pasi ndodhet brenda vijës së verdhë qytetit Lezhë dhe në **1 rast**, rezulton miratim legalizimi shtesë kati në një pallat me leje ndërtimi 8 kat, pa paguar gjobë për **67,706 lekë**.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Lezhë, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore; për dosjen me vetëdeklarim nr. 395, datë 19.06.2013, pagesën e gjobës së pa arkëtuar prej **67,706 lekë** dhe dosjen me vetëdeklarim nr. 252, datë 22.03.2005, për pagesën e vlerës së sipërfaqes (mbi 300 m²), prej 200 m² x 8511 lekë/m² e barabartë me vlerën **1,702,200 lekë**, pasi ndodhet brenda vijës së verdhë qyteti Lezhë.

Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë,, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.**

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkohet Drejtorit Rajonal të ALUIZNI Lezhë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë

dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga puna”, për këta punonjës:

A.1. “Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 3 punonjës si më poshtë:

1. z. A.M, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë nga data 01.04.2016.

2. z. B.N, me detyrë Specialist nga data 28.01.2015-në vazhdim,

3. znj. V. Gj, me detyrë Specialiste nga data 28.01.2015-në vazhdim.

2. Znj. P.K, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:

- është miratuar sipërfaqja e parcelës ndërtimore në llojin e pasurisë “Truall”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t’i dhënë lejen, veprimet të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.

- ka objekte informale, të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim, duke mos zbatuar procedurat për s’kualifikimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pikën 5 të nenit 2 dhe nenin 39-*Përjashtimi nga Legalizimi*, Kapitulli IV i VKM nr. 280, datë 01.04.2015, urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 ndryshuar me 954, datë 25.11.2015.

- në 4 raste janë pajisur me leje legalizimi objekte që ndodhen në ne një distancë prej buzës së lumit Drin me pak se 100 metrash veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5. VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 4.

- në 4 raste janë pajisur me leje legalizimi objektet ndodhen në ne një distancë prej buzës rrugës nacionale me pak se 30 metrash veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga legalizimi”, -VKM nr. 438, date 28.06.2006 i ndryshuar Kreu I pika 2/b dhe i ç’fuqizuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” -VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2.

- nuk administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit dokumentacioni i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, për të plotësuar kushtet për fillimin e procedurave të legalizimit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1, VKM Nr. 589, datë 10.9.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit

faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale” pika 3.

- Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve.

- në të gjitha rastet e audituara në genplan nuk pasqyrohen hyrjet në objekt, veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”.

Për shkeljet në fushën e blerjeve të vogla dhe procedurat e prokurimit të kryera në periudhën e audituar të cilat janë trajtuar më hollësisht në faqen 25-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe proces verbalet përkatëse mbajtur me këta persona.

A. 2. Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në “Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 11 punonjës si më poshtë:

1. *Për z. N.L*, me detyrë Specialist
2. *Për z. A.SH*, detyrë Specialist detyrë Specialist nga data 01.04.2014-në vazhdim,
3. *Për z. M.P*, detyrë Specialist nga data 01.04.2014-në vazhdim,
4. *Për z. E.N*, detyrë Specialist nga data 01.04.2014-në vazhdim,
5. *Për z. E.N*, me detyrë Specialist nga data 26.01.2016-në vazhdim,
6. *Për z. L.N*, me detyrë Specialist nga data 19.05.2014-në vazhdim,
7. *Për z. D.L*, me detyrë Specialist nga data 28.01.2015-në vazhdim,
8. *Për z. Gj.K*, me detyrë Specialist nga data 22.04.2015-në vazhdim,
9. *Për znj. D.Gj*, me detyrë Specialist nga data 19.03.2014-në vazhdim,
10. *Për z. N.M*, me detyrë specialisti i verifikimit në vazhdim
11. *Për z. R.M*, me detyrë specialisti i verifikimit në vazhdim

Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:

- dosja nr. 052, për objekt: Godinë Banimi 1 kat, ZK nr. 8632, nr. Pasurie 10/366, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 210 m², sipërfaqe e ndërtimit 103.3 m², ndërkohë sipas shkresës së Bashkisë Lezhë nr. 3591/1, datë 29.07.2014, pasuria 10/366 ka qenë aset i Bashkisë Lezhë, por duke qenë se në kushtet aktuale, nuk ekziston më ndërtesa e vjetër, pasi aty është ngritur një ndërtesë pa leje nga z. P J dhe meqenëse është paguar tarifa e privatizimit të truallit nga ky qytetar, lejojmë përfundimin e procesit të legalizimit në emër të qytetarit P J;

- dosja nr. 118, për objekt: godinë banimi 1 kat, ZK nr. 8632, nr. pasurie 10/308, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 168 m², sipërfaqe e ndërtimit 92.67 m², në bazë të VKM nr. 611, datë 11.06.2009, tek leja e legalizimit është shënuar sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 106.32 m², ndërkohë që sipas VKM është miratuar 92.67 m², pra më tepër 13.65 m² se miratimi i VKM; - Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve.

- në **29 raste** legalizimi del se nuk është llogaritur penaliteti, pra mos zbatim i kërkesave të neneve 7 Vetëdeklarimi dhe nenit 8 Sanksionet e zbatueshme për mosrespektim afati të *Ligjit*

nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar,

- në 14 raste legalizimi nuk ndodhen në dosje dokumentet për likuidimin e taksës së infrastrukturës, në kundërshtim me pikën “ç”, të nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar që shpreh: ç) vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi dhe dokumentet e pagesës për tarifën e shërbimit, në kundërshtim me nenin 24, pika “ë” të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar

- në të gjitha rastet e audituara në genplan nuk pasqyrohen hyrjet në objekt, veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”.

- nuk administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit dokumentacioni i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, për të plotësuar kushtet për fillimin e procedurave të legalizimit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1, VKM Nr. 589, datë 10.9.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale” pika 3. (Trajtuar më hollësisht në faqen 25-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për 8 punonjës aktual, nuk propozojmë masë pasi shkalla e shkeljeve në raport me pasojat në mirë funksionimin e institucionit, nuk është në nivelin për propozim masë disiplinore, si më poshtë:

1. Për znj. J. P, me detyrë Specialist e Sektorit të hartografisë nga data 22.01.2014,
2. Për z. R.N, me detyrë Specialist e Sektorit të hartografisë nga data 22.01.2014,
3. Për z. F.G, me detyrë Specialist nga data 22.04.2015-në vazhdim
4. Për z. Xh.G, me detyrë Specialist nga data 28.09.2015-në vazhdim,
5. Për z. A.Sh, me detyrë Specialist nga data 23.04.2015-në vazhdim,
6. Për znj. A. GJ, me detyrë Specialiste Juriste e Sektorit të Legalizimeve nga data 11.02.2008-në vazhdim,
7. Për z. G.Gj, me detyrë Specialist nga data 24.08.2015-në vazhdim,
- 8.,

Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.

I. Për një ish punonjësit, që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte nga “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në **“Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”**, përkatësisht për:

1. Për z. L. Z, me detyrë Ish-Përgjegjës i Sektorit të Financës nga data 16.07.2006-01.06.2014,

Shënim: Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, nuk është njoftuar Kontrolli i Lartë i Shtetit për masat e marra sipas programeve të përgatitura për zbatimin e rekomandimeve, megjithëse ka kaluar afati ligjor 20 ditë nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, kërkesë kjo e mbështetur në nenin 15, germa “j”, të ligjit

nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga KLSH, do të kërkohet me shkresë të përsëritur zbatimi i këtij detyrimi ligjor nga drejtuesit e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Lezhë.

D. KALLËZIM PENAL:

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika “gj” e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik rast pas rasti* nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal **për 4 punonjës**, e mëposhtëm është bërë kallzim penal në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Lezhë, konkretisht:

1. **Z. P.L. me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Lezhë.**
2. **Znj. A.M, me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Hartografisë**
3. **Z. A.M, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë nga data 01.04.2016.**
4. **Z. B.N, me detyrë Specialist nga data 28.01.2015-në vazhdim,**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrotjtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R